

- **Objektivat kryesorë për buxhetin vendor të vitit 2017**

Rritja e autonomisë fiskale, rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore të NJVQV-ve për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve. Përmirësimi i sistemit të administrimit të financave publike në nivel vendor. Përmirësim i procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Financime të integruara sipas instrumentit të Politikës së Zhvillimit Rajonal, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në shpërndarje. Financimi me efektivitet dhe eficiencë i funksioneve që i janë transferuar institucionit të bashkisë si për funksionin e ujitjes dhe kullimit në sigurimin e pronës dhe rritjen e prodhimeve bujqësore, konsolidimi i funksioneve vendore dhe blegtorale.